



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Nr. 4868/7 prot.

Tiranë, më 23.7 2018

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës tuaj të datës 17.7.2018

**SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT  
Z. FATMIR HOXHA**

**AV. JULIAN MËRTIRI  
RRUGA "ISMAIL QEMALI"  
PALL. 11/1, AP.1  
TIRANË**

I nderuar z. Hoxha,

Me cilësinë e Kryetares së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ju vë në dijeni se u njoha me kërkesën tuaj të datës 17.7.2018, protokolluar me tonën nr. 4868/6, dt. 17.7.2018, me anë të së cilës kërkoni sqarime dhe shpjegime lidhur me kërkesën e depozituar pranë Komisionit me nr. 4868/5 prot., datë 29.6.2018.

Sqaroj se, në përputhje me të drejtën tuaj për të ushtruar ankim, Komisioni, vendimin e pranimit të marrë nga trupa gjykuese e ka përcjellë në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, si organi kompetent për shqyrtimin e tij së bashku me dokumentacionin përkatës.

Për këtë arsye, kërkesa e përsëritur për informacion në lidhje me pranimin e ankimit, formën, mënyrën dhe argumentet e tij, i është drejtuar organit jokompetent tanimë, pasi Komisioni nuk e zotëron më dosjen e çështjes suaj.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

**KRYETARI**  
Genta Tafa (Bungo)

